

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2022*

24.05.2022

Ora 09:30

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit për caktimin e relatorit të Kërkesës nr. 1, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vendosje të sanksionit administrativ, zonjës Eriselda Sefa, kryetare e Bashkisë Lushnje”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:**
- **Stafi KQZ: Y. Merkaj, E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje të gjithëve! Me vendimin nr. 168, datë 19 Maj 2022 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar denoncimin e Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj zonjës Eriselda Sefa kandidate për kryetare Bashkie Lushnje, zonjës Ogerta Manastirliu, ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zotit Pjerin Vogli, drejtor i Spitalit “Ihsan Çabej”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur ndër të tjera “konstatimin e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit Nr. 9, dt. 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, nga ana e zonjës Eriselda Sefa, kandidate për kryetare të Bashkisë Lushnje, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste. Gjithashtu ka vendosur t’i kërkojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e sanksionit administrativ. Në datën 23.05.2022 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka dërguar kërkesën Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve ku kërkon të verë në lëvizje këtë Komision duke vendosur sanksion administrativ ndaj zonjës Eriselda Sefa në masën 50 mijë lekë. Duke qenë se kërkesa i drejtohet Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve,

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2022*

procedura e shortit është e njëjtë si në rastet e tjera. Referuar nenit 14 të rregullores së KAS-it, do të zhvillohet procedura e shortit për caktimin e relatorit. Kemi përgatitur pesë shirita letre të bardhë, ku në një të një prej tyre është vendosur Kërkesa e Komisionerit, ndërsa katër shirita janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat palosen dhe futen në 5 gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë të cilat vendosen në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezentë në sallë, atëherë një përfaqësues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të tërheqë goglat në emër dhe për llogari të tyre duke filluar nga rendi alfabetik rritës. Fillojmë me zotin Elvin Lako, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe Ledio Braho. Fillojmë tërheqjen e goglave:

Tërhiqet në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmali – Kërkesa nr. 1 e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit, relatori i Kërkesës nr. 1 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vendosje të sanksionit administrativ” është zoti Ilirjan Rusmali. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

